

VENDIM
Nr. 495, datë 10.6.2015

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E DREJTËSISË, TË PRONËS NR. 139, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 8890, OBJEKTE B130”, ME VENDNDODHJE NË MËZES, TIRANË, TË DISA OBJEKTEVE E TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 109, ME EMËRTIM “SHA, RIPARIM ARTILERIE”, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, të pronës nr. 139, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 8890, Objekte b130”, me vendndodhje në Mëzes, Tiranë, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme (S1) prej 13 236 (trembëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) m², brenda territorit të pronës nr. 109, me emërtim “SHA, Riparim Artilerie”, me vend-ndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për plotësimin e nevojave institucionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

2. Prona nr. 139, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 8890, Objekte b130”, me vend-ndodhje në Mëzes, Tiranë, si dhe objektet e sipërfaqja truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme (S1) prej 13 236 (trembëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) m², brenda territorit të pronës nr. 109, me emërtim “SHA, Riparim Artilerie”, me vendndodhje në Brar, Tiranë, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

3. Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e pronave, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t’i tjetër-sojnë ato apo t’ua japin në përdorim të tretëve.


4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Drejtësisë, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Ministria e Mbrojtjes në administrim të Ministrisë së Drejtësisë.

Miratohet
Komandanti i Komandës Mbeshtetse
Gjeneral Brigade Ylber DOGJANI



Miratohet
Komandanti i Komandës Mbeshjetse
Gjeneral Brigade Ylber DOGJANI



579
700

579
450



Shpjeguese.

Sip. e përgjithëshme = 89530.35 m²

Sip. me ndërtim = 2269.79 m²

ne sip. e ndërtimit nuk është përfshirë
depo kimise tip tunel

— Kufiri i repartit

Shenim-Kjo planvendosje u hartua sipas dokumentacionit teknik të marrë nga arkivi i I.G.J.U-së dhe në
zbatim të shkresës me nr.3631/1 dt.05-05-2015,të SHSHPPFA.

4
579
200

Ripunuar Majë 2015.

4
395 200

395 450

395 850

Ripunoi
Ing:Albert MURATI

Shkalla 1:2500

Pergj.Sek. Ramiz HAXHIU

DREJTOR I I.G.J.U-së
N/Kol Zydi ALCANI



Plan vendosja e prones nr.109 SHA Riparim Artilerie Brar,TIRANE.

Sip. dhe objektet që kerkohen për kalim nga
Ministria e Mbrojtjes në administrim te Ministrisë së Drejtësisë.

stemi i koordinatave shtetere

584
000

583
950

583
700

4
583

450

4
404.700

404.950

405.150

405.200



Miratohet
Komandanti i Komandës Mbështetse
Gjeneral Brigade Ylber DOGJANI

Shpjeguese prona109

Sip e pergjithshme = 43169.2 m2
Kufiri i repartit

Sip S1 = 13236.0 m2 sip.qe kërkohet për kalim në administrim nga MM, për Ministrin e Drejtësisë, bashkë me Objektet me nr.(19,20,27,28,28/1,29,30,31,32.)

Sip S3 = 11754.2 m2 (sip dhënë ne administrim te Ministrise se Kultures "TKOBAP".)

Sip S2 = 18179 m2 (sip.dhënë ne administrim te DPA).

Shenim-Kjo planvendosje u hartua sipas dokumentacionit teknik të marrë nga arkivi i I.G.J.U-së dhe në zbatim te shkreses me nr.3631/1 dt.05-05-2015,të SHSHPPFA.

Ripunuar Majë 2015.

Ripunoi
Ing:Albert MURATI

Shkalla 1:2500

DREJTOR I I.G.J.I.U-
N/Kol Zydi ALCAN

